**V E N D I M**
**Nr.265, datë 7.6.1993**

**PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË KËSTIT TË PARË TË ANËTARËSISË SË SHQIPËRISË NË IDB**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të paguhet shuma ekuivalente e vlerës 230.000 USD në lekë shqiptare, si këst i parë i anëtarësisë së Shqipërisë në Bankën Islamike të Zhvillimit (IDB).

2. Kjo shumë do të përdoret si financim për ndërtimin e Institutit të Gjuhëve Arabe, fondi i të cilit është falas nga IDB.

3. Burim financimi do të jetë fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1993.

4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë për të bërë çeljen e llogarisë, pagesën e menjëhershme, si dhe kontrollin e shpenzimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
**Aleksandër Meksi**